

## Referat Kinderbildung und -betreuung Frühe Sprachförderung

### **Të dashur prindër!**

Zhvillimi gjuhësor fillon qysh para lindjes. Gjuha e trupit – ngjyra e tingullit – melodika e të folurit – prindërit transportojnë ndjenja dhe disponime, të cilat fëmija i kupton shumë kohë përpara se të mund të flasë. Për këtë arsye, është e rëndësishme që fëmijët të flasin në gjuhën e tyre të parë, që ata ta zhvillojnë tutje dhe ta shpalosin gjuhën e tyre të parë. Se a mund ta përvetësojë fëmija drejt një gjuhë të dytë, varet nga zhvillimi i gjuhës së parë të tij. Përkrahja dhe kujdesi ndaj gjuhës së parë ndikon pozitivisht në përvetësimin e gjuhës së dytë!

Në kopsht, krahas gjuhës gjermane, fëmija juaj mëson edhe shumë gjëra tjera, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tij. Në mënyrë që të mund ta përkrahim fëmijën tuaj aty ku duhet dhe ta mbështesim në përvetësimin e gjuhës së dytë, pra gjermane, ekziston oferta pa pagesë për konstatimin e nivelit të njohjes së gjuhës së parë, në bashkëpunim me një këshilltare gjuhësore si dhe me një perkthyes/përkthyes.

Përkthyesi/ja luan me fëmijën tuaj dhe me këtë rast vëzhgon se si flet fëmija në gjuhën e parë.

Në fund dëshirojmë t'ju ftojme në një bisedë për prindër, gjatë së cilës do të jetë i / e pranishëm/me edhe përkthyesi/ja.

Të gjitha informatat lidhur me fëmijën tuaj, gjegjësisht përmbajtjet e bisedës sonë mbesin në kopsht dhe nuk përcillen tek persona të tjerë.

### **Termini për konstatimin e nivelit të njohjes së gjuhës është më:**

I gëzohemi ardhjes suaj!

Përsëritje të sinqerta,